

LIGJI NR. 08/L-146

**PËR ZBATIMIN E SANKSIONEVE FINANCIARE NDËRKOMBËTARE
TË SHËNJESTRUARA**

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR ZBATIMIN E SANKSIONEVE FINANCIARE NDËRKOMBËTARE
TË SHËNJESTRUARA**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i masave, autoriteteve kompetente dhe procedurave për propozimin, miratimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara në Republikën e Kosovës, të cilat kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, zhvillimin dhe forcimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe arritjes së objektivave të tjera në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, aktet e Bashkimit Evropian, vendimet e organizatave të tjera ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është anëtare ose të cilat i zbaton.

2. Ky ligj është në përputhshmëri me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 2580/2001 të 27 dhjetorit 2001 mbi masat specifike kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara me qëllim luftimin e terrorizmit.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet ndaj personave të përcaktuar dhe personave për të cilët ka filluar procedura e përcaktimit, si dhe ndaj subjekteve sipas paragrafit 2 të këtij neni, për të cilët ekziston dyshim i arsyeshëm për përfshirje në çfarëdo formë të terrorizmit, financimit të terrorizmit dhe përhapjes, të përcaktuar nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, aktet e organizatave të tjera ndërkombëtare dhe në bazë të këtij ligji, të kryera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

2. Sanksionet financiare ndërkombëtare të shënjestruara, sipas këtij ligji zbatohen ndaj:

2.1. shteteve;

2.2. shtetasve të Republikës së Kosovës;

2.3. të huajit apo personit pa shtetësi që banon në territorin e Republikës së Kosovës në përputhje me ligjin që rregullon kushtet për qëndrimin e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës dhe në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të miratuara;

2.4. shoqërive tregtare, personave tjerë juridikë dhe autoriteteve të licencuara apo të

regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;

2.5. shoqërive të huaja që janë të angazhuara në veprimtari ekonomike në territorin e Republikës së Kosovës; dhe

2.6. personit fizik ose juridik të huaj i cili ka në pronësi, posedim ose nën kontroll fonde ose pasuri të tjera në Republikën e Kosovës.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Definicionet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Fonde apo pasuritë tjera** - çfarëdo lloj pasurie, duke përfshirë por mos u kufizuar në ato financiare, depozita monetare, burimet ekonomike (përfshirë naftën dhe burimet e tjera natyrore) dhe pasuri tjetër të çfarëdo lloji, materiale ose jo materiale, të prekshme ose të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht mënyrës së fitimit, si dhe dokumentet ligjore ose instrumente të çdo lloji, duke përfshirë ato elektronike ose digjitale, të cilat dëshmojnë të drejtën ose interesin në këto fonde apo pasuri të tjera, duke përfshirë por mos u kufizuar në kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bono, pagesat, letër kreditë, si dhe çfarëdo interesi, dividende ose e hyrë tjetër, si dhe vlerat që grumbullohen ose gjenerohen nga këto fonde ose pasuri të tjera, dhe çdo pasuri tjetër që potencialisht mund të përdoret për të marrë fonde, mallra ose shërbime.

1.2. **Ngrirja** - është ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, pjesëmarrjeje në transferim, shndërrim, tjetërsim ose lëvizje e fondeve dhe e pasurive të tjera, për pasuri të tjera të luajtshme apo paluajtshme, që zotërohen ose kontrollohen nga personat ose entitetet e përcaktuara sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse në përputhje me këtë ligj. Fondet dhe pasuritë e tjera të ngrira përkohësisht mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës së ngrirjes së përkohshme.

1.3. **Fondet e personave të përcaktuar** - fondet e përcaktuara në nënparagrafin 1.1 të këtij neni, të zotëruara, mbajtura, kontrolluara ose të menaxhuara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga personat e përcaktuar.

1.4. **Person ose entitet i përcaktuar** - çdo individ (person fizik), grup, ndërmarrje dhe/ose entitet (person juridik dhe/ose marrëveshje juridike) ndaj të cilit zbatohen sanksionet financiare të shënjestruara sipas:

1.4.1. Në kontekst të luftimit të terrorizmit dhe financimit të terrorizmit:

1.4.1.1. Rezolutës 1267 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 1989 (2011) dhe 2253 (2015) dhe çdo rezolute të tanishme ose pasardhëse nga Këshilli i Sigurimit;

1.4.1.2. Rezolutës 1988 (2011) të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe çdo rezolute të tanishme ose pasardhëse nga Këshilli i Sigurimit;

1.4.1.3. Përcaktimet e juridiksioneve tjera sipas Rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të pranuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (tutje Qeveria) si pjesë e listës vendore të përcaktuar me nenin 6 të këtij Ligji;

1.4.1.4. Aktet e organizatave ndërkombëtare në të cilat Kosova është

anëtare apo i zbaton, mbi bazën e propozimeve të autoriteteve kompetente shtetërore ose kërkesës së arsyetuar të një shteti tjetër siç është vendosur nga Qeveria;

1.4.1.5. personin fizik ose juridik nga lista vendore e përcaktuar nga neni 6 i këtij ligji;

1.4.2. Në kontekstin e luftimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe financimit të tij:

1.4.2.1. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1718 (2006) dhe çdo rezolutë e tanishme ose pasardhëse nga Këshilli i Sigurimit;

1.4.2.2. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 2231 (2015) dhe çdo rezolutë e tanishme ose pasardhëse nga Këshilli i Sigurimit.

1.5. **Përcaktim** - identifikimin e individit (personit fizik), grupit, ndërmarrjes ose entitetit (personit juridik ose marrëveshjes juridike) që i nënshtrohet sanksioneve financiare të shënjestruara si person ose entitet i përcaktuar në kontekstin e luftimit të terrorizmit dhe financimit të terrorizmit (referuar gjithashtu si përcaktime të lidhura me terrorizmin) ose përhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe financimi i saj (referuar gjithashtu si përcaktime të lidhura me përhapjen). Sa i përket përcaktimeve në përputhje me rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1373 (2001), kjo përfshin përcaktimin se sanksionet përkatëse do të zbatohen ndaj personit ose entitetit dhe komunikimin publik të këtij përcaktimi. Referencat për "përcaktimet" vlejné njësoj për "listimin".

1.6. **Kriteret e përcaktimit** - i referohen:

1.6.1. Në kontekstin e luftimit të terrorizmit dhe financimit të terrorizmit (referuar gjithashtu si kritere të përcaktimit të terrorizmit):

1.6.1.1. Në lidhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit 1267 (1999), 1989 (2011), 2253 (2015) dhe çdo rezolutë të tanishme ose të ardhshme nga Këshilli i Sigurimit:

1.6.1.1.1. Çdo person ose entitet që merr pjesë në financimin, planifikimin, lehtësimin, përgatitjen ose kryerjen e veprimeve ose aktiviteteve nga, në bashkëpunim me, nën emër të, në emër të, ose në mbështetje të; furnizimit, shitjes ose transferimit të armëve dhe materialit të ndërlidhur me të; rekrutimi për; ose përndryshe mbështesin akte ose aktivitete të Al-Kaidës ose ISIS, ose ndonjë celule, bashkëpunëtor, grupi të ndarë ose derivat i saj; ose

1.6.1.1.2. Çdo ndërmarrje e zotëruar ose e kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo person ose entitet i përcaktuar sipas nën-nën nënparagrafit 1.6.1.1 (pika 1.6.1.1.1) më lart, ose nga persona që veprojnë në emër të tyre ose nën udhëzimin e tyre;

1.6.1.2. Në lidhje me rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1988 (2011) dhe çdo rezolutë të tanishme ose të ardhshme nga Këshilli i Sigurimit:

1.6.1.2.1. Çdo person ose entitet që merr pjesë në financimin, planifikimin, lehtësimin, përgatitjen ose kryerjen e veprimeve ose aktiviteteve nga, në bashkëpunim me, nën emrin të, në emër të, ose në mbështetje të; furnizimit, shitjes ose transferimit të armëve dhe materialit të ndërlidhur me të; rekrutimi për; ose përndryshe mbështesin aktet ose aktivitetet e atyre të përcaktuar dhe individëve

të tjerë, grupeve, ndërmarrjeve dhe entiteteve të lidhura me Talibanët që përbëjnë një kërcënim ndaj paqes, stabilitetit dhe sigurisë së Afganistanit; ose

1.6.1.2.2. Çdo ndërmarrje e zotëruar ose e kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo person ose entitet i përcaktuar sipas nën-nën nënparagrafit 1.6.1.2. (pika 1.6.1.2.1) më lart, ose nga persona që vepron në emër të tyre ose nën drejtim të tyre.

1.6.1.3. Në lidhje me rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1373 (2001) dhe përcaktimet e juridiksioneve tjera të pranuar nga Qeveria si pjesë e listës vendore të përcaktuar me nenin 6 të këtij ligji:

1.6.1.3.1. Çdo person ose entitet që kryen ose përpiqet të kryejë akte terroriste, ose që merr pjesë ose lehtëson kryerjen e akteve terroriste;

1.6.1.3.2. Çdo entitet në pronësi ose të kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo person ose entitet i përcaktuar sipas nën-nën nënparagrafit 1.6.1.3. (pika 1.6.1.3.1) më lart; ose

1.6.1.3.3. Çdo person ose entitet që vepron në emër të, ose nën drejtimin e, çdo personi ose entiteti të caktuar sipas nën-nën nënparagrafit 1.6.1.3. (pika 1.6.1.3.1.) më lart.

1.6.2. Në kontekstin e luftimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe financimit të tij (referuar gjithashtu si kritere të përcaktimit në lidhje me përhapjen):

1.6.2.1. Në lidhje me rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1718 (2006) dhe çdo rezolutë të tanishme ose të ardhshme nga Këshilli i Sigurimit:

1.6.2.1.1. Çdo person ose entitet i angazhuar në Republikën Popullore Demokratike të Koresë (RPDK), në programet bërthamore të ndërlidhura dhe programe të tjera të ndërlidhura me armët e shkatërrimit në masë dhe raketa balistike;

1.6.2.1.2. Çdo person ose entitet që siguron mbështetje për programet bërthamore të ndërlidhura me RPDK-në, programe të tjera të ndërlidhura me armët e shkatërrimit në masë dhe raketa balistike, përfshirë përmes mjeteve të paligjshme;

1.6.2.1.3. Çdo person ose entitet që vepron në emër të ose nën drejtimin e ndonjë personi ose entiteti të përcaktuar sipas nën-nën nënparagrafit 1.6.2.1. (pika 1.6.2.1.1.) dhe / ose nën-nën nënparagrafi 1.6.2.1. (pika 1.6.2.1.2) më lart;

1.6.2.1.4. Çdo person juridik ose entitet në pronësi ose të kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo person ose entitet i përcaktuar sipas nën-nën nënparagrafit 1.6.2.1. (pika 1.6.2.1.1.) dhe/ose nën-nën nënparagrafi 1.6.2.1. (pika 1.6.2.1.2) më lart;

1.6.2.1.5. Çdo person ose entitet që ka ndihmuar në shmangien e sanksioneve ose në shkeljen e dispozitave të rezolutave të Këshillit të Sigurimit 1718 (2006) dhe 1874 (2009);

1.6.2.1.6. Çdo person ose entitet që ka kontribuar në programet e ndaluara të RPDK-së, aktivitetet e ndaluara nga rezolutat e ndërlidhura me RPDK-në, ose në shmangien e dispozitave; ose

1.6.2.1.7. Çdo entitet i Qeverisë së RPKD-së ose Partia e Punëtorëve të Koresë, ose person ose entitet që vepron në emër të tyre ose nën drejtimin e tyre, ose nga ndonjë entitet në pronësi ose të kontrolluar prej tyre, që vendet përcaktojnë se janë të ndërlidhur me programe të raketave bërthamore ose balistike të RPKD-së ose aktivitete të tjera të ndaluar nga rezoluta 1718 (2006) e Këshillit të Sigurimit dhe çdo rezolutë e tanishme ose e ardhshme nga Këshilli i Sigurimit.

1.6.2.2. Në lidhje me rezolutën e Këshillit të Sigurimit 2231 (2015) dhe çdo rezolutë të tanishme ose të ardhshme nga Këshilli i Sigurimit:

1.6.2.2.1. Çdo person ose entitet që është përfshirë, i ndërlidhur drejtpërdrejt në, ose ka siguruar mbështetje për përhapjen e veprimtarive bërthamore të Iranit në kundërshtim me angazhimet e Iranit në Planin e Përbashkët të Përgjithshëm të Veprimit (PPPV) ose zhvillimin e sistemeve të shpërndarjes së armëve bërthamore, përfshirë përmes involvimit në prokurimin e gjëseneve të ndaluar, mallrave, pajisjeve, materialeve dhe teknologjisë së ndaluar të specifikuar në Aneksin B të rezolutës 2231(2015) të Këshillit të Sigurimit;

1.6.2.2.2. Çdo person ose entitet që ndihmon personat ose entitetet e përcaktuara në shmangien ose veprimin në kundërshtim me angazhimet e Iranit në Planin e Përbashkët të Përgjithshëm të Veprimit (PPPV) ose rezolutën 2231 (2015) e Këshillit të Sigurimit; dhe

1.6.2.2.3. Çdo person ose entitet që vepron në emër ose në drejtim të ndonjë personi ose entiteti të specifikuar në nën-nën nënparagrafin 1.6.2.2. (pika 1.6.2.2.1) dhe/ose nën-nën nënparagrafi 1.6.2.2 (pika 1.6.2.2.2.) më lart, ose nga ndonjë entitet në pronësi ose të kontrolluar prej tyre.

1.7. Kontrolli i një personi juridik, grupi ose entiteti –cilindo nga rastet në vijim:

1.7.1. zotërimi i të drejtës për të emëruar ose shkarkuar një pjesë të madhe të anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese ose mbikëqyrëse të personit juridik, grupit ose entitetit të tillë;

1.7.2. emërimi, duke ushtruar vetëm të drejtën e tij të votës i pjesës më të madhe të anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese ose mbikëqyrëse të personit juridik, grupit ose entitetit të tillë;

1.7.3. kontrolli absolut, sipas një marrëveshjeje me aksionarë ose anëtarë të tjerë të atij personi juridik, grupi ose entiteti, i shumicës së të drejtave të votës të aksionarëve ose anëtarëve të atij personi juridik, grupi ose entiteti;

1.7.4. e drejta për të ushtruar ndikim dominues mbi një person juridik, grup ose entitet, në zbatim të një kontrate të lidhur me personin juridik, grupin ose entitetin në fjalë ose ndonjë dispozitë të aktit të themelimit ose statutit, kur ligji që rregullon këtë person juridik, grup ose entitet lejon që ai t'iu nënshtrohet kontratave apo dispozitave të tilla;

1.7.5. kompetenca për të ushtruar një ndikim dominues sipas nën-nënparagrafit 1.7.4. të këtij neni, pa qenë zotërues i asaj të drejte;

1.7.6. e drejta për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aseteve të një personi juridik, grupi ose entiteti;

1.7.7. menaxhimi i biznesit të një personi juridik, grupi ose entiteti mbi baza të unifikuara, duke publikuar llogari të konsoliduara;

1.7.8. pjesëmarrja, bashkërisht ose individualisht, në pasivet financiare të një personi juridik, grupi ose entiteti, ose garantimi i tyre.

1.8. **Financimi i terrorizmit** – ka kuptimin e njëjtë si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

1.9. **Terrorist** - ka kuptimin e njëjtë si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

1.10. **Grup terrorist** - ka kuptimin e njëjtë si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

1.11. **Përhapja** –aktivitetet e çdo pale jo shtetërore për prodhimin, blerjen, posedimin, zhvillimin, transportimin, transferimin ose përdorimin e armëve bërthamore, kimike ose biologjike dhe mjeteve të tyre të lëshimit, veçanërisht për qëllime terroriste, si dhe përpjekjet për t'u angazhuar në cilindo nga aktivitetet e mësipërme, pjesëmarrja në to si bashkëpunëtor, ndihmës ose financues.

1.12. **Veprim terrorist** - ka kuptimin e njëjtë si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

1.13. **Bordi** – Bordin Mbikëqyrës të Njesisë për Inteligjencë Financiare të themeluar sipas Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, duke përfshirë edhe një përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Punë të Jashtme dhe një nga Ministria përgjegjëse për Tregti dhe Industri nga fusha për tregti me mallra strategjike.

1.14. **Person raportues** - personin fizik ose juridik, si dhe subjektet raportuese të përkufizuara sipas ligjit përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

1.15. **Sanksione financiare të shënjestruara** - ngrirjen dhe bllokimin e fondeve ose pasurive tjera, me qëllim parandalimin që të njëjtat të vihen në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për të mirën e personave dhe entiteteve të përcaktuara.

1.16. **Pa vonesë/menjëherë** - detyrimin për të ndërmarrë veprime dhe/apo ngrirë fondet ose pasuritë e tjera të personave dhe entiteteve të përcaktuara në periudhën më të shkurtër kohore, idealisht brenda disa orëve nga një përcaktim i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo komiteteve relevante, si dhe për qëllime të Rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nënkupton që sapo të ketë dyshim të arsyeshëm për të besuar se një person ose entitet është terrorist, është apo ka qenë i përfshirë në aktivitete të terrorizmit; financimin e terrorizmit; i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist ose është i përfshirë në përhapjen.

1.17. **Sekuestrimi** - është ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të tjera të ndërlidhura, pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarrura nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet ose pasuritë e sekuestruara mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës së sekuestrimit.

1.18. **Bllokim i përkohshëm** - është ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të

tjera të ndërlidhura, pjesëmarrje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve e të pasurive të tjera, për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet dhe pasuritë e tjera, të bllokuara përkohësisht mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës së bllokimit të përkohshëm.

1.19. **Fonde** - janë pasuri të çdo lloji, qofshin këto materiale ose jomateriale, të prekshme ose të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht se si janë fituar, si dhe dokumente apo instrumente ligjore të çdo forme, duke përfshirë ato elektronike apo digjitale, të cilat dëshmojnë të drejtën apo interesat në këto pasuri.

1.20. **Lista e përcaktimeve** - i referohet listave të personave ose entiteteve të përcaktuara të publikuara nga ose në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për zbatimin e sanksioneve financiare të shënjestruara në kontekstin e luftimit të terrorizmit dhe financimit të terrorizmit (listat e përcaktimit të lidhura me terrorizmin) dhe/ose përhapjen dhe financimin e armëve të shkatërrimit në masë (listat e përcaktimit në lidhje me përhapjen).

1.21. **Entitet** - është një subjekt i ndryshëm nga shteti, personi fizik dhe juridik, i huaj ose vendas, ndaj të cilit vendoset masa për ngrirjen e fondeve dhe pasurive tjera, sipas përcaktimeve të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe sipas këtij ligji.

1.22. **Marrëveshjet juridike** - truste dhe marrëveshje të tjera juridike të ngjashme.

KAPITULLI II

LISTA E PERSONAVE TË PËRCAKTUAR DHE PROCEDURAT E PËRCAKTIMIT

Neni 4

Sanksionet ndërkombëtare ndaj personave të përcaktuar sipas Listave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

1. Zbatimi i Sanksioneve Financiare të Shënjestruara bëhet sipas kushteve të përgjithshme të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare dhe këtij ligji.

2. Lista e konsoliduar e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në gjuhën angleze dhe çdo amendamentim pasues do të publikohet në ueb faqen e Njesisë për Inteligjencë Financiare (tutje: NjIF-K) pa vonesë, dhe kanë fuqi të drejtpërdrejt dhe menjëherëshme.

3. Për çfarëdo ndryshimi të bërë në listë sipas paragrafit 1 të këtij neni, NjIF-K njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për financa, ministrinë përgjegjëse për punë të brendshme, ministrinë përgjegjëse për punë të jashtme, ministrinë përgjegjëse për tregti dhe industri, Doganën e Kosovës, Administratën Tatimore, Prokurorinë e Shtetit, Bankën Qendrore të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, subjektet raportuese dhe institucionet tjera të cilat vlerësohet e nevojshme të informohen.

4. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme përmes aktit nënligjor përcakton mënyrën e zbatimit të këtij neni.

Neni 5

Propozimet e autoriteteve shtetërore për përcaktimin e personave në listën vendore

1. Ministria përgjegjëse për punë të brendshme, ministria përgjegjëse për punë të jashtme, ministria përgjegjëse për tregti dhe industri, Prokuroria e Shtetit, Agjencia e Kosovës për

Inteligjencë, NjIF-K, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore si dhe institucionet e tjera, të cilat në kuadër të fushëveprimit të tyre janë vënë në dijeni ose kanë arsye për të besuar për përfshirjen e personit fizik apo juridik në çfarëdo forme, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet personave të tjerë, në veprimet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, janë të detyruar të dorëzojnë propozimin për përcaktim tek ministri përgjegjës për financa, dhe të propozojnë marrjen e masave në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Propozimi për përcaktim siç parashihet në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përmbajë të gjitha informatat relevante që tregojnë arsyet për të besuar se një person është terrorist, është apo ka qenë i përfshirë në aktivitete të terrorizmit, financimit të terrorizmit, i përfshirë në aktivitete të një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist ose është i ndërlidhur me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

3. Propozimi sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë informata të detajuara në lidhje me asetet që mund të jenë subjekt i ngrirjes, dhe i njëjti duhet të bëhet menjëherë dhe pa vonesë.

4. Për shqyrtimin e propozimit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, ministri përgjegjës për financat mund të thërrasë Bordin si një komitet të posaçëm këshillimor që të mbildhet pa vonesë nga pranimi i propozimit.

5. Ministri përgjegjës për financat, pa vonesë, i propozon Qeverisë për përcaktimin e personave në listën vendore dhe marrjen e masave të parashikuara me këtë ligj.

6. Procedura lidhur me paraqitjen e propozimeve nga autoritetet shtetërore për përcaktimin e personave në listën vendore rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga ministria përgjegjëse për financa dhe të aprovuar nga Qeveria.

Neni 6

Vendimi për listim të personave të përcaktuar në listën vendore

1. Qeveria pa vonesë merr vendim për përfshirjen në listën vendore të personave dhe entiteteve të përcaktuara në bazë të:

1.1. Propozimit për përcaktim të bërë sipas nenit 5, paragrafi 5 të këtij ligji, bazuar në dyshimin e arsyeshëm se një person i tillë është apo ka qenë i përfshirë në aktivitete të terrorizmit, financimit të terrorizmit, ; i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist ose është i ndërlidhur me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

1.2. Kërkesës së pranuar nga një shtet i huaj sipas nenit 9 të këtij ligji.

2. Qeveria merr vendim bazuar në dyshimin e arsyeshëm, pavarësisht nëse është duke u zhvilluar një hetim në lidhje me subjektin e propozuar.

3. Vendimi për listim duhet të përmbajë:

3.1. detajet e plota të personit të përcaktuar, përfshirë arsyen e përfshirjes;

3.2. detajet e plota të aseteve që duhen ngrirë;

3.3. njoftimin e organeve kompetente për ekzekutimin e vendimeve sipas ligjit;

3.4. listën e personave të cilëve duhet dorëzuar vendimi.

4. Për çdo ndryshim në listën e personave të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, NjIF-K njofton pa vonesë subjektet raportuese që janë të detyruar të zbatojnë veprimet dhe masat për

parandalimin e financimit të terrorizmit dhe për përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

5. Me kërkesën e ministrit përgjegjës për financa, Qeveria shqyrton arsyeshmërinë e përcaktimeve së paku një (1) herë në vit.

Neni 7

Propozimi për përfshirjen e personit të përcaktuar në listën e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

1. Qeveria, nëpërmjet kanaleve diplomatike, i propozon Komitetit të Këshillit të Sigurimit 1267/1989 dhe Komitetit të Këshillit të Sigurimit 1988 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që një person të përfshihet në listën e personave të përcaktuar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nëse:

1.1. personi i cili është përfshirë në listën vendore të personave të përcaktuar nga Qeveria, është i ndërlidhur me personat ose organizatat e përcaktuara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;

1.2. personi nuk është në listën e personave të përcaktuar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

2. Propozimi për përcaktim sipas paragrafit 1 të këtij neni përmban informatat relevante të cilat identifikojnë qartë subjektin e propozimit, dhe të cilat mbështeten në arsyen për të dyshuar se personi është apo ka qenë i përfshirë në aktivitete të terrorizmit, financimin e terrorizmit; i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist, ose është i lidhur me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

3. Propozimi sipas paragrafit 1 të këtij neni përmban informata të detajuara lidhur me pasuritë që mund të jenë subjekt i urdhrit për ngrirje dhe informacione të tjera siç kërkohet me standardet përkatëse të komiteteve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dhe aty ku është e mundur, propozimi duhet të dorëzohet duke përdorur format standarde të miratuara nga këto Komitete.

4. Nëse bëhet propozimi për përcaktim sipas paragrafit 1 të këtij neni, në propozim duhet të specifikohet që Republika e Kosovës mund të prezantohet publikisht nga Kombet e Bashkuara si shtet i cili është kompetent të propozojë persona për përcaktim, si dhe të definojë qartë se cilat pjesë të propozimit dhe informacioneve plotësuese duhet të trajtohen si konfidenciale dhe që nuk vihen publikisht në dispozicion pa marrëveshje me shkrim me Qeverinë.

Neni 8

Parashtrimi i kërkesës shtetit të huaj

1. Nëpërmjet kanaleve diplomatike, ministria përgjegjëse për punë të jashtme dërgon kërkesën drejtuar shtetit të huaj për të ngrirë pasuritë e personit të përcaktuar sipas vendimit të Qeverisë, nëse ka dyshime se personi i përcaktuar ka asete në atë shtet.

2. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat përkatëse të personit, të cilat vërtetojnë dyshimin e arsyeshëm se personi është ose ka qenë i angazhuar në aktivitete që përfshijnë terrorizmin; financim të terrorizmit, i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist apo ka lidhje me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Propozimi po ashtu duhet të përmbajë informata të detajuara lidhur me asetet që mund të jenë subjekt i urdhrit të ngrirjes.

3. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme ndërmerr hapat e nevojshëm për të marrë informata lidhur me veprimet e shtetit të huaj në përgjigje të kërkesës së bërë sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 9

Listimi sipas kërkesës së shtetit të huaj

1. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme, kërkesën e pranuar nga shteti i huaj për përfshirjen e një personi të përcaktuar në listën vendore e dërgon tek Qeveria pa vonesë.
2. Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë të dhëna për personin fizik apo juridik i cili propozohet të përfshihet në listën vendore, përshkrimin e rrethanave me të gjitha dëshmitë dhe dokumentacionin në dispozicion që konfirmojnë dyshimin e arsyeshëm dhe lidhjen me Republikën e Kosovës, dhe të dhëna mbi fondet dhe/ose pasuritë që mund të jenë subjekt i urdhrit për ngrirje. Nëse informacionet e tilla nuk shoqërojnë kërkesën, Qeveria kërkon nga ministria përgjegjëse për punë të jashtme që të kërkojë nga shteti i huaj sigurimin dhe dërgimin e këtyre informacioneve dhe materialeve.
3. Pas shqyrtimit të kërkesës sipas paragrafit 1 të këtij neni, Qeveria do të shqyrtojë kërkesën dhe bazuar në dyshimin e arsyeshëm se një person është apo ka qenë i angazhuar në aktivitete që përfshijnë terrorizmin; financimin e terrorizmit; i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist apo ka lidhje me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, pa vonesë merr vendim lidhur me propozimin për përfshirjen e personit në listën e personave të përcaktuar sipas nenit 6 të këtij ligji.
4. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme njofton pa vonesë shtetin e huaj kërkues për përfshirjen apo jo të personit në listën e personave të përcaktuar.

Neni 10

Njoftimi për personin e përcaktuar

1. Vendimi për përfshirjen në listën e personave të përcaktuar i marrë nga Qeveria sipas nenit 6 dhe nenit 9 të këtij ligji i dërgohet personit të përcaktuar, në përputhje me dispozitat e ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.
2. Vendimi i Qeverisë për përfshirjen në listën e personave të përcaktuar i marrë sipas nenit 6 dhe nenit 9 të këtij ligji është i ekzekutueshëm menjëherë. Ky vendim publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në ueb-faqen zyrtare të NjIF-K dhe të institucioneve tjera përkatëse.

Neni 11

Propozimi për delistim të personave të përcaktuar në listat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

1. Qeveria, nëpërmjet kanaleve diplomatike, propozon që një person i përcaktuar të hiqet nga lista e personave të përcaktuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nëse:
 - 1.1. pas shqyrtimit të arsyeshmërisë për përfshirjen në listën e personave të përcaktuar sipas nenit 7 të këtij ligji, merr vendim se nuk mund të arsyetojë edhe më tej vendimin e vet fillestar;
 - 1.2 në rast të vdekjes së personit të përcaktuar;
 - 1.3. pas kërkesës për rishikim të personit të përcaktuar merr vendim të favorshëm.
2. Propozimi i bërë sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë informatat e kërkuara nga komitetet e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të mundësuar marrjen e një vendimi.
3. Personat e listuar që kërkojnë të largohen nga listat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në rast të përcaktimit në përputhje me rezolutat 1267 (1999) dhe 1989 (2011), mund

të paraqesin kërkesën e tyre për heqjen nga lista tek Zyra e Ombudspersonit të Kombeve të Bashkuara. Informatat në lidhje me këtë procedurë do të publikohen në faqen zyrtare elektronike të ministrisë përgjegjëse për punë të jashtme.

Neni 12

Propozimi për delistim të personave të përcaktuar në listat vendore

1. Ndryshimi ose shfuqizimi i vendimit të Qeverisë për listimin e personave ose entiteteve të përcaktuar mund të bëhet *ex officio* ose pas propozimit të institucioneve kompetente kur vërtetohen rrethanat dhe faktet të cilat e bëjnë të panevojshme zbatimin e mëtejshëm të tij në këto raste:

1.1. kur pas shqyrtimit të arsyeshmërisë për përfshirjen në listën e personave të përcaktuar sipas nenit 6 të këtij ligji, Qeveria merr vendim se nuk mund të arsyetojë edhe më tej vendimin e vet fillestar;

1.2. si rrjedhojë e një vendimi përkatës të Bashkimit Evropian, organizatave tjera ndërkombëtare ose sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Kosovës është anëtare ose i zbaton ato;

1.3. për shkak të vendimit të heqjes nga lista të personit nga vendi që ka kërkuar listimin;

1.4. për shkak të vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente sipas nenit 23 të këtij ligji;

1.5. në rast të vdekjes së personit të përcaktuar, dhe

1.6. për shkak të kërkesës së bazuar të personave të cenuar gabimisht nga masat e parashikuara me këtë ligj.

KAPITULLI III

DETYRIMET E PERSONAVE RAPORTUES

Neni 13

Kërkesat për raportim të drejtpërdrejtë

1. Subjektet raportuese miratojnë dhe zbatojnë politikat dhe procedurat për të përcaktuar nëse klientët e tyre janë persona të përcaktuar, si dhe identifikojnë dhe vlerësojnë rreziqet e mundshme të ndërlidhura me terrorizmin, financimin e terrorizmit dhe përhapjen, si dhe marrin masat e duhura për të zbutur këto rreziqe, të cilat janë në përpjesëtim me rreziqet e terrorizmit, financimit të terrorizmit, dhe përhapjen.

2. Personat raportues ngrijnë fondet apo asetet e tjera të personit të përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë sapo të vihen në dijeni për përcaktimin e personit apo entitetit nga komitetet përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, organizatat ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është anëtare ose vendimet e të cilave i zbaton, menjëherë dhe pa njoftim paraprak apo udhëzim ligjor nga një autoritet kompetent apo nga gjykata dhe pa vonesë raportojnë hollësitë e veprimit në NjIF-K.

3. Asetet e ngrira sipas paragrafit 2 të këtij neni shtrihen tek të gjitha asetet e përcaktuara sipas nenit 17, paragrafi 2 të këtij ligji.

4. Subjektet raportuese janë të detyruara të raportojnë menjëherë pa njoftim paraprak të personave të dyshuar në NjIF-K, kur kanë të dhëna ose dyshime për veprime financiare, transaksione, fonde ose veprime të tjera, të kryera apo që tentohet të kryhen, e që kanë për qëllim kryerjen apo financimin e veprave terroriste apo përhapjes, pavarësisht nga vlera e tyre.

5. Çdo person që ka dijëni për veprime financiare, transaksione, fonde ose veprime të tjera, të kryera apo që tentohet të kryhen, që kanë për qëllim kryerjen apo financimin e veprave terroriste apo përhapjes, është i detyruar që pa njoftim paraprak dhe përfshirje të personave të dyshuar apo të prekur, të njoftojë menjëherë NjIF-K.
6. Personi raportues, shtetas i Republikës së Kosovës apo personat ose entitetet brenda juridiksionit të Republikës së Kosovës u ndalohej të vejnë asetet e veta ose të një personi tjetër në dispozicion të personit të përcaktuar, apo të entitetit juridik ose personit fizik i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon personin juridik, drejtpërdrejt ose tërthorazi nga personi i përcaktuar ose personi që vepron për dhe në emër të personit të përcaktuar ose sipas udhëzimeve të tij, të fondeve apo pasurive të tjera, burimeve ekonomike, shërbimeve financiare apo të tjera, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pjesërisht apo tërësisht.
7. Raporti i dorëzuar sipas paragrafit 2 të këtij neni përmban të dhënat identifikuese të personit të përcaktuar, si dhe dokument dhe informacione tjera, të shkruara ose elektronike, relevante për identifikimin e personit të përcaktuar, pasuritë dhe bizneset ose çfarëdo marrëdhënie tjetër të ngjashme.
8. Raporti i referuar në paragrafin 2 të këtij neni, përfshirë edhe transaksionet e mbetura në tentativë, si dhe informacioni i referuar në paragrafin 7 të këtij neni dërgohen me shkrim ose në formë elektronike, dhe në rast se raportimi bëhet nëpërmjet telefonit, raportimi i tillë nuk e përjashton detyrimin e dorëzimit të raportit të shkruar në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.
9. Personat raportues, drejtorët, zyrtarët, punonjësit e përkohshëm apo të përhershëm të subjektit raportues të cilët përgatisin apo transmetojnë raporte në pajtim me këtë ligj, nuk zbulojnë fakte për raportin që është dorëzuar ose është në proces për t'u dorëzuar, nuk e sigurojnë këtë raport, as nuk e komunikojnë ndonjë të dhënë të përfshirë në raport apo për atë raport, përfshirë kur një informacion i tillë është duke u përgatitur për t'u raportuar, apo kur hetimet për terrorizëm, financim të terrorizmit ose përhapje janë duke u kryer ose mund të kryhen, asnjë personi apo entiteti, përfshirë çdo person apo entitet të përfshirë në transaksionin i cili përfshihet në raport, përveç NjIF-K, pa pasur autorizim me shkrim nga NjIF-K, prokurori publik ose gjykata.
10. NjIF-K ruan identitetin e personave, subjekteve raportuese dhe të punonjësve të tyre që kanë raportuar në përputhje me këtë nen.
11. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr akt nënligjor me qëllim të zbatimit të këtij neni.

Neni 14

Detyrimet e organeve kompetente

1. Organet kompetente që licencojnë dhe/ose regjistrojnë entitetet juridike duhet të konsultojnë listën e personave të përcaktuar para dhe gjatë procesit të licencimit dhe/ose regjistrimit.
2. Zyrrat kadastrale komunale, noterët, si dhe të gjitha institucionet tjera kompetente që mbajnë ose administrojnë regjistra të fondeve dhe pasurive, duhet të konsultojnë listën e personave të përcaktuar para ose gjatë regjistrimit, hartimit ose vërtetimit të një kontrate apo transaksioni të pasurive të paluajtshme.
3. Organet kompetente sipas paragrafit 2 të këtij neni nuk do të bëjnë regjistrimin dhe as nuk përpilojnë kontratë të paluajtshmerisë, dhe pa vonesë do të raportojnë në NjIF-K, nëse personi i përcaktuar figuron si drejtor, person përgjegjës ose ka shumicën e aksioneve në pronësi, fondacion, truste ose marrëveshje ligjore ose shfaqet si palë kontraktuese në një transaksion të pasurive të paluajtshme, si dhe asetet e mbajtur nga ta, duhet të ngrihen menjëherë. Raporti për pasuritë e tilla duhet dorëzuar në NjIF-K pa vonesë.
4. Procedura dhe mënyra e zbatimit të obligimeve të përcaktuara me këtë nen rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga ministria përgjegjëse për financa, dhe miratohet nga Qeveria.

Neni 15 **Procedura në NjIF-K**

1. NjIF-K është e autorizuar të kërkojë nga autoritetet shtetërore, organizatat, subjektet raportuese dhe personat që ushtrojnë funksione publike të dhëna, dokumente dhe informata relevante për personin e përcaktuar dhe pasurinë e tij.
2. Autoritetet shtetërore, organizatat, subjektet raportuese dhe personat që ushtrojnë funksione publike do t'i raportojnë NjIF-K menjëherë lidhur me të gjitha të dhënat, dokumentet dhe informatat relevante që ndërlidhen me personin e përcaktuar dhe pasurinë e tij.
3. NjIF-K, merr masa për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave për:
 - 3.1. personat e përcaktuar apo personat e propozuar për listim në listën vendore;
 - 3.2. fondet dhe pasuritë e tjera që disponojnë ose ndërlidhen me të drejta ose interesa të tjerë të personave të përcaktuar apo personave të propozuar për listim në listën vendore.
4. Mbledhja, përpunimi, analiza, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave për zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit dhe përhapjes sipas këtij ligji bëhet nga NjIF-K.
5. NjIF-K raporton pa vonesë te ministri përgjegjës për financa lidhur me detajet për ngrirjen e ndonjë asemi të raportuar sipas dispozitave të nenit 13 të këtij ligji, dhe i propozon menjëherë ministrit përgjegjës për financa ngrirjen e përkohshme të fondeve dhe pasurive të tjera.
6. Procedura dhe mënyra e raportimit të të dhënave për personin e përcaktuar dhe asetet e tij nga autoritetet shtetërore, organizatat dhe personat që ushtrojnë funksione publike, rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga ministria përgjegjëse për financa.

Neni 16 **Njoftimi për marrjen e vendimit për mos-listim**

Nëse pas pranimit të raportit të përgatitur nga NjIF-K sipas nenit 15, paragrafi 5 i këtij ligji, ministri përgjegjës për financa konstaton se personi i propozuar nuk i përmbush kriteret për të qenë person i përcaktuar dhe se asetet nuk plotësojnë kriteret e ngrirjes, përmes NjIF-K, i njëjti dërgon pa vonesë një njoftim me shkrim subjektit raportues se mund të vazhdojë me aktivitetet e pezulluara.

KAPITULLI IV **MASAT PËR FONDET APO PASURITË TJERA**

Neni 17 **Detyrimi për ngrirjen e asetëve**

1. Të gjithë personat raportues brenda vendit duhet të ngrijnë, pa vonesë dhe pa njoftim paraprak, fondet ose pasuritë tjera të personave dhe entiteteve të përcaktuara sipas nenit 6 të këtij ligji.
2. Detyrimi për ngrirje duhet të shtrihet tek:
 - 2.1. të gjitha fondet ose pasuritë tjera që janë në pronësi ose të kontrolluara nga personi ose entiteti i përcaktuar, dhe jo vetëm ato që mund të lidhen me një akt të caktuar terrorist, komplot ose kërcënim;
 - 2.2. të gjitha fondet ose pasuritë tjera që janë në pronësi ose të kontrolluara nga personi ose entiteti i përcaktuar, dhe jo vetëm ato që mund të lidhen me një akt të caktuar,

- komplot ose kërcënim për përhapje;
- 2.3. fondet ose pasuritë tjera që janë në pronësi të plotë, të përbashkët ose të kontrolluara, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga persona ose entitete të përcaktuara;
- 2.4. fondet ose pasuritë tjera të nxjerra ose të krijuara nga fonde ose pasuri në pronësi ose të kontrolluara drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga persona ose entitete të përcaktuara, si dhe
- 2.5. fondet ose pasuritë tjera të personave dhe entiteteve që veprojnë në emër të personave ose sipas udhëzimeve të personave apo entiteteve të përcaktuara.
3. Çdo ngrirje e fondeve ose pasurive të tjera sipas këtij neni duhet të raportohet tek NJIF-K.

Neni 18

Bllokimi dhe sekuestrimi i fondeve apo pasurive tjera

1. Pas marrjes së kërkesës konform nenit 6 dhe 9 të këtij ligji, ministri përgjegjës për financa mund të urdhëroj bllokimin e përkohshëm të fondeve ose pasurive të tjera të personave të propozuar për listim, si dhe për të cilët ka dyshim të arsyeshëm për përfshirje në çfarëdo forme në vepra të terrorizmit dhe të financimit të tij dhe përhapjes të kryera apo që tentohet të kryhen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
2. Ministri përgjegjës për financa pa vonesë nxjerr urdhër për sekuestrimin e fondeve dhe pasurive të tjera të personave të përcaktuar, të evidentuara e të verifikuara nga organet kompetente, si dhe kalimin nën administrim të Agjencisë për Menaxhimin dhe Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.
3. Urdhri sipas paragrafit 2 të këtij neni hyn në fuqi menjëherë, dhe i njëjti i komunikohet personit të përcaktuar sipas dispozitave të ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Masat e parashikuara vendosen për të gjitha fondet dhe pasuritë e tjera për të cilat personi i përcaktuar ushtron të drejta pronësie, kontrolli ose të drejta apo interesa tjera, pavarësisht nga fakti se kush i ka në zotërim apo në përdorim fondet apo pasuritë e tjera, sikurse edhe për çdo fond e pasuri tjetër që është gjetur në posedim ose mbahet nga personat e përcaktuar. Kjo masë shtrihet edhe ndaj asetëve të përcaktuara në nenin 17, paragrafi 2 të këtij ligji.
5. Urdhri për sekuestrim sipas paragrafit 2 të këtij neni i dërgohet Agjencisë për Menaxhimin dhe Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, si dhe institucioneve, subjekteve raportuese dhe organeve kompetente, në të cilat janë evidentuar fonde dhe pasuri të tjera, të cilat marrin masa për ekzekutimin e menjëhershëm të këtij urdhri.
6. Pas vendosjes së masës të sekuestrimit, Agjencia për Menaxhimin dhe Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ushtron të gjitha të drejtat e kontrollit mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara, përfshirë posedimin, administrimin dhe veprime të tjera që i konsideron të nevojshme.
7. Procedurat dhe rregullat e marrjes në administrim, shpenzimet për administrim dhe kthim të fondeve dhe pasurive të tjera të sekuestruara rregullohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara.

Neni 19

Kohëzgjatja e masave për fondet apo pasuritë tjera

Masat për fondet apo pasuritë tjera zgjasin derisa personi i përcaktuar gjendet në listën e personave të përcaktuar, ose deri në marrjen e një vendimi nga gjykata kompetente në pajtim me nenin 25 të këtij ligji.

Neni 20**Shtesat për llogaritë e ngrira**

1. Llogaritë e personave të përcaktuar të cilat janë të ngrira në pajtim me këtë ligj, mund të pranojnë fonde ose mjete shtesë.
2. Fondet e lejuara për t'u shtuar sipas paragrafit 1 të këtij neni janë interesi ose fitime të tjera që duhet të paguhet në ato llogari ose pagesa që duhet të paguhet sipas kontratave, marrëveshjeve ose detyrime që kanë lindur para datës në të cilën këto llogari janë ngrirë.
3. Çdo fond i tillë i shtuar në një llogari të ngrirë sipas dispozitave të këtij neni bëhet edhe vetë i ngrirë dhe i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji.

Neni 21**Procedimi penal dhe pasuror**

Pavarësisht nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, prokuroria dhe gjykata, në zbatim të dispozitave të kodit përkatës të procedurës penale, ligjit përkatës për kompetenca të zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe legjislacionit tjetër në fuqi mund të procedojnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve dhe të pasurive të tjera të bllokuara përkohësisht ose të sekuestruara në zbatim të këtij ligji.

Neni 22**Përdorimi i lejuar i një pjese të aseteve**

1. Ministri përgjegjës për financa, nga paraqitja e kërkesës së personit të përcaktuar, mund të vendosë dhe të autorizojë që një pjesë e pasurisë së personit të përcaktuar që i është ngrirë apo sekuestruar sipas këtij ligji, mund të lirohet nëse vërtetohet se fondet janë të domosdoshme për shpenzimet themelore të jetesës dhe se personi i përcaktuar nuk mund t'i marrë ato nga një tjetër burim ligjor. Shpenzimet themelore të jetesës sipas këtij neni janë shpenzimet e domosdoshme siç parashihet në paragrafin 2 të këtij neni dhe nuk duhet të interpretohen si shpenzime për të mbajtur një nivel jetese ose mënyrë jetese që është gëzuar para se personi apo entiteti të jetë përcaktuar.
2. Shpenzimet e domosdoshme siç parashihet në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. pagesat për shpenzimet themelore të jetesës siç janë: ushqimi, qiraja ose hipoteka, barnat dhe trajtimi mjekësor, tatimet, primet e sigurimit dhe pagesat e shërbimeve publike.
 - 2.2. për pagesën e tarifave të arsyeshme profesionale dhe rimbursimin e shpenzimeve të shkaktuara që lidhen me ofrimin e shërbimeve juridike ose tarifave dhe pagesat e shërbimit për mbajtjen ose mirëmbajtjen e fondeve të ngrira ose aseteve të tjera financiare.
3. Shpenzimet e domosdoshme mund të përfshijnë pagesën për shkak të kontratës nëse personi i caktuar ka hyrë në kontratë para listimit të tij si person i përcaktuar.
4. Shpenzimet e domosdoshme nuk mund të përfshijnë pagesën për ndonjë kontratë që përcaktohet në lidhje me ndonjë nga artikujt, materialet, pajisjet, mallrat, teknologjitë, ndihmën, trajnimin, asistencën financiare, investimet, ndërmjetësimin ose shërbimet e ndaluara të referuara në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
5. Çdo pagesë nga pasuria e ngrirë apo sekuestruar e personit të përcaktuar të lëshuar sipas paragrafëve 2 (2.1), 3 dhe 4 të këtij neni mund të bëhet drejtpërdrejt ose tërthorazi për personin ose entitetin i cili është person i përcaktuar.
6. Nëse ministri përgjegjës për financa vendos të lejojë përdorimin e një pjese të fondeve të ngrira, siç është paraparë në këtë nen, ai përmes kanaleve diplomatike njofton paraprakisht

Komitetin përkatës të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për qëllimin e tij për ta bërë këtë. Nëse pas dhjetë (10) ditëve të punës pas paraqitjes së njoftimit të tillë në Komitetin përkatës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ministri përgjegjës për financa nuk merr përgjigje negative ndaj parashtresës së tij, i njëjti mund të autorizojë lirin e pjesës së lejuar të fondeve të ngrira sipas rastit.

7. Kundër vendimit të ministrit përgjegjës për financa për refuzimin e lejit të përdorimit të një pjese të aseteve, parashtruesi i kërkesës sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjë ankesë në gjykatën kompetente.

8. Dispozitat e këtij neni përdoren përshtatshëm nga ministri përgjegjës për financa edhe në rastet e listave vendore, si dhe me akt nënligjorë do të përcaktohen procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij neni.

Neni 23

Mbrojtja e palëve të treta në mirëbesim

Asetet e ngrira apo sekuestruara sipas këtij ligji mund të jenë subjekt i përmbarimit me vendim gjyqësor të formës së prerë, me qëllim të mbrojtjes së palëve të treta në mirëbesim.

KAPITULLI V PROCEDURA GJYQËSORE

Neni 24

Konflikti administrativ kundër vendimit për listimin e personit

1. Vendimi për listim të personit të përcaktuar sipas nenit 6 dhe 9 të këtij ligji është i formës së prerë dhe përfundimtar në procedurën administrative dhe nuk lejohet ankesë, ndaj tij mund të inicohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente brenda tridhjetë (30) ditësh prej ditës së njoftimit për vendimin e Qeverisë për listim.

2. Konflikti administrativ mund të inicohet vetëm në rastin ku personi pretendon se është identifikuar gabimisht me personin e përcaktuar.

3. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Qeverisë për listim.

Neni 25

Konflikti administrativ kundër vendimit për sekuestrim

1. Vendimi me të cilin urdhërohet sekuestrimi i aseteve është i formës së prerë dhe përfundimtar në procedurë administrative dhe nuk lejohet ankesë, por mund të inicohet konflikti administrativ.

2. Konflikti administrativ mund të inicohet në gjykatën kompetente nëse:

2.1. personi të cilit i është sekuestruar pasuria nuk është person i përcaktuar;

2.2. asetet e sekuestruara nuk janë asete që duhet të ngrihen sipas këtij ligji.

3. Sipas këtij ligji, konflikti administrativ mund të inicohet gjatë periudhës në të cilën asetet janë të sekuestruara.

4. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të ministrit përgjegjës për financa që urdhëron sekuestrimin e aseteve.

5. Për dëmin e shkaktuar në zbatim të këtij ligji nuk mund të kërkohet dëmshpërblim nga Republika e Kosovës dhe as nga organet të cilët e kanë ndërmarrë masën kufizuese, përjashtimisht kur dëmi është shkaktuar qëllimisht apo pakujdesisë së skajshme.

KAPITULLI VI BASHKËPUNIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 26

Organet kompetente për mbikëqyrje

1. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme mbikëqyr zbatimin e këtij ligji.
2. Nëse gjatë mbikëqyrjes ministria përgjegjëse për punë të jashtme gjen parregullsi ose paligjshmëri në lidhje me respektimin e këtij ligji, atëherë e njëjta:
 - 2.1. kërkon korrigjimin e parregullsive dhe mangësive sa më parë që është e mundur;
 - 2.2. vendosë për procedurën e përshtatshme;
 - 2.3. merr masa dhe aktivitete të tjera sipas kompetencave që i jepen me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë.
3. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme harton raportin vjetor lidhur me zbatimin e këtij ligji deri në fund të muajit mars të vitit aktual për vitin paraprak, dhe të njëjtin e dërgon në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
4. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme përpilon statistika dhe kur e konsideron të arsyeshme harton raporte dhe duke u bazuar në to bënë rekomandime organeve kompetente në lidhje me masat që duhet të ndërmerren dhe legjislacioni që duhet të miratohet për të zbatuar këtë ligj.
5. NjIF-K është autoritet kompetent për inspektimin dhe mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese të përcaktuara sipas nënparagrafit 1.14 të nenit 3 të këtij ligji dhe definimit të tyre sipas Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit për sa i përket pajtueshmërisë me kërkesat e këtij ligj dhe akteve nënligjore me rregullat dhe rregulloret përkatëse të nxjerra në zbatim të këtij ligji.
6. Inspektimi dhe mbikëqyrja e pajtueshmërisë sipas paragrafit 5 të këtij neni, do të bëhet në përputhje me kompetencat mbikëqyrëse të NjIF-K të përcaktuara sipas Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

Neni 27

Bashkëpunimi vendor dhe shkëmbimi i të dhënave

1. Ministri përgjegjës për financa, ministri përgjegjës për punë të brendshme, ministri përgjegjës për punë të jashtme, ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë, ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes, Kryeprokurori i Shtetit dhe Prokurorive tjera, Guvernatori i Bankës Qendrore, Drejtori i Agjencionit të Kosovës për Inteligjencë dhe autoritetet tjera relevante shkëmbejnë informacione dhe të dhëna në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me personat e përcaktuar, për të cilët ka dyshim të arsyeshëm për përfshirje në çfarëdo forme në vepra të terrorizmit, financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, ose për të cilët ka filluar procedura për përcaktim, si dhe bashkëpunojnë ndërmjet vete për qëllime të përmbushjes së përgjegjësive të dala nga ky ligj,
2. Bordi do të kryej funksionin e mekanizmit përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore për parandalimin, luftimin e terrorizmit, financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë bazuar në rreziqet e identifikuar, si dhe ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në pajtim me këtë ligj.
3. Për qëllime të paragrafit 2 të këtij neni, Bordi mund të krijoj grupe pune për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore për parandalimin, luftimin e financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe përcaktimin e prioritetëve afatgjata dhe afatshkurta.

4. Të gjitha autoritetet kompetente që kanë përgjegjësi sipas këtij ligji për parandalimin, luftimin e terrorizmit, financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, si dhe subjektet raportuese dhe personat ose subjektet tjera që kanë detyrime ose funksione sipas këtij ligji mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësive.

5. Në mbajtjen e të dhënave statistikore, personat, subjektet raportuese dhe autoritetet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni ndërveprojnë me ministrinë përgjegjëse për financa, NJIF-K dhe Ministrinë përgjegjëse për Punë të Jashtme, dhe sipas rastit mund të përcaktohet lloji i të dhënave statistikore që mund të kërkohen.

6. Të dhënat statistikore të mbajtura sipas këtij neni vihen në dispozicion të Bordit brenda afateve të përcaktuara nga ky i fundit, për ti mundësuar që të rishikoj efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime e nevojshme.

KAPITULLI VII DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 28 Shkeljet administrative

1. Dështimi nga personat raportues të definuar në nënparagrafin 1.14 të nenit 3 të këtij ligji, për t'iu përmbajtur obligimeve ligjore të parashikuara në këtë ligj, që nuk janë vepra penale, përbëjnë shkelje administrative për shqiptimin e të cilave do të jetë kompetent NjIF-K.

2. Ndëshkimet për shkeljet administrative mund të jenë si në vijim:

2.1. paralajmërim;

2.2. rekomandim për masa përmirësuese për subjektin raportues me qëllim të arritjes së pajtueshmërisë;

2.3 pezullim të përkohshëm apo zëvendësim të drejtuesve të strukturave përgjegjëse për zbatimin e obligimeve të këtij ligji;

2.4. gjobë;

2.5. vërejtje publike

3. Gjopa e paraparë në nën-paragrafin 2.4 të këtij neni shqiptohet si në vijim:

4. Për personin juridik gjobë në shumën prej një mijë (1,000) deri në dyzet mijë (40,000) euro për shkelje administrative nëse:

4.1. nuk vepron pa vonesë, sipas vendimit të Qeverisë për zbatimin e tij, apo përcaktimit të bërë në bazë të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;

4.2. nuk zbaton obligimet e përcaktuara me këtë ligj në kuadër të fushëveprimit të tij;

4.3. krijon marrëdhënie biznesi, ofron shërbime ose asistencë për personat e përcaktuar, entitetin juridik ose personin fizik i cili përfundimisht zotërohet ose kontrollohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi nga personi i përcaktuar ose personi që vepron për dhe në emër të personit të përcaktuar ose sipas udhëzimeve të tij;

4.4. nuk njofton NjIF-K pa vonesë lidhur me fondet dhe pasuritë që personat e përcaktuar mund të kenë në zotërim dhe nuk bënë ngrirjen e tyre;

4.5. fondet dhe/ose asetet tjera, shitja dhe blerja e të cilave është e ndaluar sipas këtij ligji i vë në dispozicion të personit të përcaktuar, përveç rasteve të lirit të pjesës së pasurisë apo fondeve të tjera në pajtim me këtë ligj;

4.6. në kuadër të fushëveprimit të tij nuk ndërmerr masa për të bllokuar dhe zbatuar urdhrin për bllokimin e përkohshëm.

5. Për shkelje administrative sipas paragrafit 2 të këtij neni, me gjobë në shumën prej pesëqind (500) deri në katër mijë (4,000) euro do të ndëshkohet edhe personi përgjegjës i personit juridik.

6. Për shkelje administrative nga paragrafi 2 i këtij neni, personi fizik dënohet me gjobë në shumën prej pesëqind (500) deri në katër mijë (4,000) euro.

7. Gjatë përcaktimit të ndëshkimit administrativ sipas këtij neni merren në konsideratë të gjitha rrethanat relevante, duke përfshirë edhe shkallën dhe kohëzgjatjen e mos-përputhshmërisë, shkallën e përgjegjësisë, fuqinë financiare të subjektit raportues, humbjet e shkaktuar si pasojë e shkeljes, shkeljet e mëparshme si dhe nivelin e bashkëpunimit të subjektit raportues.

8. Procedurat e ndëshkimit, ankimit, shqyrtimit, dhe ekzekutimit të vendimeve për ndëshkime administrative bëhen në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të terrorizmit.

Neni 29

Mbrojtja e konfidencialitetit

1. Të dhënat e siguruar në zbatim të këtij ligji mund të përdoren vetëm për qëllimet e zbatimit të këtij ligji dhe për qëllime të tjera të caktuara me këtë ligj.

2. Organet përgjegjëse për zbatim të këtij ligji, përpunojnë të dhënat në përputhje me legjislacionin për informacionin e klasifikuar dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Institucionet përgjegjëse që marrin të dhëna, njoftime dhe raportime në zbatim të këtij ligji, nuk mund të bëjnë publike fakte, për të cilat janë vënë në dijeni gjatë ose për shkak të detyrës, madje edhe pas ndërprerjes së detyrës. Informacione të tilla mund të përdoren vetëm për qëllimet e ofruara në pajtim me këtë ligj.

4. Asnjë veprim për përgjegjësinë civile a penale dhe asnjë sanksion profesional nuk mund të ndërmerret ndaj ndonjë personi fizik apo juridik ose subjekti raportues, sipas këtij ligji, ose ndaj drejtorëve, zyrtarëve dhe punonjësve të tyre të përkohshëm apo të përhershëm bazuar vetëm në transmetimin e informatave në mirëbesim, dorëzimin e raporteve apo veprimeve të tjera në pajtim me këtë ligj.

KAPITULLI VIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 30

Dispozita kalimtare

Aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Terrorizmit, do të zbatohen përshtatshëmrisht me dispozitat e këtij ligji, deri në miratimin e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatimin e këtij ligji.

Neni 31
Miratimi i akteve nënligjore

Ministria përgjegjëse për Punë të Jashtme në zbatim të paragrafit 4 të nenit 4 të këtij ligji, ministria përgjegjëse për financa në zbatim të paragrafit 11 të nenit 13, paragrafit 6 të nenit 15, paragrafit 8 të nenit 22 të këtij ligji dhe Qeveria në zbatim të paragrafit 6 të nenit 5, paragrafit 4 të nenit 14 të këtij ligji në konsultim me akterët tjerë relevant siç mund të jetë e nevojshme, miratojnë, ndryshojnë, apo shfuqizojnë aktet nënligjore për zbatimin e detyrimeve të dala nga ky ligj, me qëllim të promovimit dhe sigurimit të pajtueshmërisë me këtë ligj. Aktet nënligjore do të nxirren brenda gjashtë (6) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-146
9 Dhjetor 2022

Shpallur me dekretin Nr. DL-349/2022, datë 23.12.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu